



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
K R Y E S I A

Nr. 25 prot.

Tiranë, më 07. 01.2020

V E N D I M

Nr. 7, datë 07.01.2020

**Për vijim procedure për kandidatët që kanë aplikuar për avancim në
titullin akademik**

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 07.01.2020; në mbështetje të Ligjit 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*; dhe nenit 7, pika 5-12 të Statutit; referuar vendimit të Kryesisë nr. 37, datë 11.11.2019 *Për shpalljen e vendeve të lira dhe fushave përkatëse për lëvizjet e brendshme*; pasi konstatoi se në përgjigje të shkresës së Akademisë së Shkencave, drejtuar institucioneve përgjegjëse për verifikim të dhënash, në lidhje me dekriminalizimin dhe pastërtinë e figurës, sipas Ligjit 138/2015 dhe Ligjit 45/2015, këto institucione kanë dhënë zyrtarisht përgjigje pozitive;

V e n d o s i :

1. Të miratojë vijimin e procedurës së avancimit në titullin *akademik* për dy anëtarët e Asamblesë: akad. asoc. Nestor Thereska dhe akad. asoc. Shaban Sinani.
2. Komisioni për vlerësimin teknik të dokumentacionit dhe Seksionet përkatëse, bazuar në kriteret e **Aneksit nr. 2** të Statutit, të ushtrojnë të drejtën dhe përgjegjësitë e tyre për përgatitjen e raportit sipas nenit 7, pika 10 të Statutit. Votimi në Asamble të bëhet në mbledhjen e muajit shkurt 2020.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave dhe kryetarët e Seksioneve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

A